REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCAVE

KORRIK 2025

# EKONOMIA DHE BUXHETI

## Raport Mujor

# EKONOMIA DHE BUXHETI

## Raport Mujor

## Korrik 2025

© Ministria e Financave, 2025
Drejtoria e Përgjithshme e Programimit Makroekonomik dhe Fiskal
Bulevardi "Dëshmorët e Kombit", Nr. 3, Tiranë

**E-mail: Rei.Qerimi@financa.gov.al,  Elkejdo.Pacani@financa.gov.al**

# Përmbajtja

**VEÇORITË KRYESORE** ________________________________________________ **2**

**ZHVILLIMET EKONOMIKE** ____________________________________________ **3**

1. Indeksi i Çmimeve të Konsumit __________________________________ 3
2. Kursi Mesatar i Këmbimit _______________________________________ 4
3. Ecuria e Normave të Interesit të Depozitave dhe Huave ______________ 5
4. Bilanci i Pagesave ____________________________________________ 6
5. Mjetet Valutore Neto të Sistemit Bankar___________________________ 7
6. Kredia për Ekonominë __________________________________________ 8
7. Oferta e Parasë ______________________________________________ 9
8. Depozitat sipas Burimeve_______________________________________10

**SEKTORI FISKAL** ________________________________________________ **11**

1. Buxheti i Konsoliduar __________________________________________ 11
2. Të Ardhurat Sipas Burimeve ____________________________________ 12
3. Financimi i Bilancit Fiskal _______________________________________ 12

**ANEKSI STATISTIKOR** ________________________________________________ **13**

# Veçoritë Kryesore

- Indeksi i çmimeve të konsumit, në korrik 2025, arriti në 119.10. Norma vjetore e inflacionit për muajin korrik 2025 ishte 2.5 përqind;
- Kursi mesatar i këmbimit të monedhës vendase me dy monedhat kryesore të huaja për muajin korrik 2025 ishte 83.62 lekë për dollarë dhe 97.72 lekë për euro;
- Normat mesatare të interesit të depozitave në lekë sipas individëve dhe korporatave jofinanciare gjatë muajit korrik 2025 shënuan normën 1.58 dhe 2.37 përqind;
- Normat mesatare të interesit të huave në lekë sipas individëve dhe korporatave jo-financiare gjatë muajit korrik 2025 shënuan normën 6.45 dhe 6.82 përqind;
- Oferta totale e parasë, e matur nga agregati M3, arriti në rreth 1,858,397 milionë lekë në muajin korrik 2025, duke shënuar një rritje prej rreth 8.3 përqind krahasuar me një vit më parë;
- Bilanci i përgjithshëm i pagesave për tremujorin e dytë 2025 rezultoi pozitiv, në rritje të mjeteve të rezervës valutore, duke shënuar vlerën prej rreth 52.9 milionë euro;
- Situata buxhetore për periudhën janar- korrik 2025 rezultoi me një suficit të përgjithshëm prej rreth 31.6 miliardë lekë, ndërkohë që ishte planifikuar një suficit prej 29.6 miliardë lekë;
- Të ardhurat gjithsej të realizuara për periudhën janar-korrik 2025 arritën në rreth 433.5 miliardë lekë, ose afërsisht 7.6 përqind më shumë se periudha janar-korrik 2024 dhe 1.3 përqind më shumë se plani i periudhës;
- Shpenzimet gjithsej gjatë së njëjtës periudhë arritën në rreth 401.9 miliardë lekë, ose rreth 15.4 përqind më shumë se periudha janar-korrik 2024 dhe 0.9 përqind më shumë se plani i periudhës.

# Zhvillimet Ekonomike

## 1. Indeksi i Çmimeve të Konsumit

Inflacioni vjetor për muajin korrik 2025 shënoi normën 2.5%, duke reflektuar një rritje në krahasim me një vit më parë kur ky ndryshim ishte 2.1%. Ndryshimi mujor i Indeksit të Çmimeve të Konsumit (IÇK) në muajin korrik 2025, krahasuar me një muaj më parë, ka shënuar rënie me 0.1%. Inflacioni mesatar për periudhën janar-korrik 2025 është 2.2%.

Fig. 1




Ndryshimet mujore/vjetore të IÇK-së, Korrik 2025

Burimi: INSTAT

Nga tërësia e mallrave dhe shërbimeve që përbëjnë shportën e konsumit, grupet të cilat patën kontributin më të lartë në inflacionin e përgjithshëm ishin:

"Ushqime dhe pije joalkoolike" me rritje vjetore të çmimit prej +3.1%, duke kontribuar me +1.08 pikë përqindje në inflacionin e përgjithshëm prej +2.5%.

"Qera, ujë, lëndë djegëse dhe energji" me rritje vjetore të çmimit prej +3.0%, duke kontribuar me +0.61 pikë përqindje në inflacionin e përgjithshëm prej +2.5%.

"Mobilim, pajisje shtëpie dhe mirëmbajtje", me rritje vjetore +2.7%, duke kontribuar me +0.20 pikë përqindje në inflacionin e përgjithshëm prej +2.5%.

"Pije alkoolike dhe duhan" me rritje vjetore të çmimit prej +3.4%, duke kontribuar me +0.17 pikë përqindje në inflacionin e përgjithshëm prej +2.5%.

"Mallra dhe shërbime të ndryshme" me rritje vjetore të çmimit prej +1.2%, duke kontribuar me +0.07 pikë përqindje në inflacionin e përgjithshëm prej +2.5%.

"Veshje dhe këpucë" me rritje vjetore të çmimit prej +0.9%, duke kontribuar me +0.03 pikë përqindje në inflacionin e përgjithshëm prej +2.5%.

"Hotele, kafene dhe restorante" me rritje vjetore të çmimit prej +2.0%, duke kontribuar me +0.11 pikë përqindje në inflacionin e përgjithshëm prej +2.5%.

Tab - 1 Ndryshimi vjetor i Indeksit të Çmimeve të Konsumit (në %)

| VITI | Janar | Shkurt | Mars | Prill | Maj | Qershor | Korrik | Gusht | Shtator | Tetor | Nëntor | Dhjetor |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| **2024** | 3.4 | 2.6 | 2.3 | 2.1 | 2.2 | 2.1 | **2.1** | 2.0 | 1.9 | 1.9 | 2.0 | 2.1 |
| **2025** | 2.0 | 1.9 | 2.1 | 2.3 | 2.2 | 2.4 | **2.5** | | | | | |

Burimi: INSTAT

## 2. Kursi mesatar i këmbimit

Kursi mesatar i këmbimit të lekut kundrejt euros në muajin korrik 2025 arriti në 97.72 lekë/euro, duke u ulur me 0.35 përqind krahasuar me një muaj më parë. Në fund të muajit korrik, një euro u këmbye me 97.47 lekë. Gjatë periudhës janar-korrik 2025 kundrejt dhjetor 2024, vihet re një mbiçmim i lehtë i euros ndaj lekut në 0.3 përqind.

Kursi mesatar i këmbimit të lekut kundrejt dollarit amerikan në muajin korrik 2025 arriti në 83.62 lekë/dollarë, duke shënuar rënie me 1.75 përqind kundrejt një muaji më parë. Në fund të muajit korrik, kursi i këmbimit për dollarin amerikan arriti në nivelin 85.21 lekë/dollarë. Gjatë periudhës janar-korrik 2025 kundrejt dhjetor 2024, vihet re një mbiçmim i lekut ndaj dollarit në 4.7 përqind.

Kursi i këmbimit të euros me dollarin amerikan shënoi një nivel mesatar rreth 0.86 dollarë/euro për muajin korrik 2025.

Fig. 2




Ecuria e kursit të këmbimit Korrik 2025
Burimi: Banka e Shqipërisë

Në krahasim me muajin korrik të vitit të kaluar, pas një periudhe të konsiderueshme forcimi, rezulton se monedha shqiptare ka pësuar një mbiçmim ndaj monedhës europiane në masën 2.59 përqind, ndërsa kundrejt dollarit amerikan rezulton se është mbiçmuar në masën 9.60 përqind.

Presionet mbiçmuese mbi kursin e këmbimit u rishfaqën prej fundit të muajit prill, por ato paraqiten më të moderuara krahasuar me dy vitet e mëparshme. Presionet inflacioniste të brendshme mbetën të qëndrueshme duke treguar aktivitet ekonomik pranë potencialit, ndërsa presionet nga jashtë janë të dobëta, për shkak të një kursi të mbiçmuar të Lekut dhe rënies së inflacionit tek partnerët tregtarë. Forcimi i Lekut këtë vit ka qenë më i vonuar dhe më i përmbajtur, ndërkohë që tregu valutor është karakterizuar nga një luhatshmëri e ulët.

# 3. Ecuria e Normave të Interesit të Depozitave dhe Huave

Gjatë muajit korrik 2025, normat mesatare të interesit të depozitave me afat në lekë sipas Individëve dhe Korporatave jofinanciare shënuan përkatësisht normat prej 1.58 dhe 2.37 përqind. Krahasuar me një muaj më parë, normat e interesit të depozitave sipas Individëve nuk kanë ndryshuar, ndërsa për Korporatat jofinanciare janë rritur me 0.08 pikë përqindje. Ndërkohë, krahasuar me një vit më parë, normat e interesit të depozitave sipas Individëve kanë shënuar rënie me 0.41 pikë përqindje dhe janë ulur me 0.35 pikë përqindje për Korporatat jofinanciare.

Fig. 3




Normat e interesit për depozitat sipas individëve, KJF dhe BTH-12M (në %)

Burimi: Banka e Shqipërisë

Normat e interesit të bonove të thesarit 12-mujore, për muajin korrik 2025, kanë shënuar normën 2.68 përqind, nga 3.19 përqind që shënonte të njëjtën periudhë një vit më parë. Norma e bonos 12-mujore u ul me 0.07 pikë përqindje krahasuar me një muaj më parë dhe me 0.51 pikë përqindje krahasuar me një vit më parë.

Gjatë muajit korrik 2025, normat mesatare të interesit të huave sipas Individëve dhe Korporatave jofinanciare shënuan normën 6.45 dhe 6.82 përqind. Krahasuar me një muaj më parë, normat e interesit të huave sipas Individëve u rritën me 0.54 pikë përqindje, ndërsa normat e interesit sipas Korporatave jofinanciare u rritën me 0.28 pikë përqindje. Ndërkohë, krahasuar me një vit më parë, normat e interesit të huave kanë shënuar rënie me 0.24 pikë përqindje për Individët dhe rritje me 0.13 pikë përqindje për Korporatat jofinanciare.

Fig. 4




Normat e interesit për huatë sipas individëve (në %)

Burimi: Banka e Shqipërisë

# 4. Bilanci i Pagesave T2-2025

Në tremujorin e dytë të vitit 2025, Bilanci i përgjithshëm i Pagesave rezultoi pozitiv, me rritje të mjeteve të rezervës valutore, duke shënuar vlerën prej rreth 52.9 milionë euro, nga -116.8 milionë euro që ishte në tremujorin e dytë 2024.

Llogaria korrente u mbyll me balancë negative prej rreth 263 milionë euro, zgjeruar në terma vjetorë me rreth 42 milionë euro, në sfondin e përkeqësimit të bilancit tregtar në mallra. Llogaria financiare dhe kapitale rezultoi në fluks neto hyrës prej rreth 257 milionë euro, krahasuar me +158 milionë euro në tremujorin e dytë 2024.

Investimet e huaja direkte u vlerësuan në 398 milionë euro ose +0.3 përqind më shumë, krahasuar me +397 mln euro në tremujorin e dytë të vitit 2024. Të ardhurat në formën e prurjeve valutore nga emigrantët shënuan 281 milionë euro, ose +4.9 përqind, krahasuar me +268 milionë euro në tremujorin e dytë 2024.

Gjatë tremujorit të dytë 2025, mjetet e rezervës u zgjeruan me 53 milionë euro. Stoku i rezervës valutore, në fund të tremujorit të dytë 2025, shënon vlerën prej 6,727 milionë euro, mjaftueshëm për mbulimin e 7.3 muaj importe mesatare vjetore në mallra dhe shërbime .

Fig. 5




Bilanci i Pagesave T2 - 2025
Burimi: Banka e Shqipërisë

Fig. 6




Llogaria Korente T2 - 2025
Burimi: Banka e Shqipërisë

## 5. Mjetet Valutore Neto të Sistemit Bankar

Gjatë muajit korrik 2025, sistemi bankar ka shënuar vlerën prej rreth 1,058,258 milionë lekë të mjeteve valutore neto (M.V.N), duke u rritur me rreth 94,227 milionë lekë krahasuar me muajin korrik 2024. Kjo rritje ka ardhur kryesisht si pasojë e rritjes së mjeteve valutore neto në Bankën Qendrore me 98,721 milionë lekë. Krahasuar me një muaj më parë, mjetet valutore neto kanë shënuar rritje me 15,376 milionë lekë, ku më së shumti ka kontribuar rritja mujore prej 8,405 milionë lekë në Bankën Qendrore.

Fig. 7




Ecuria e M.V.N. të sistemit Korrik'24-Korrik'25

Burimi: Banka e Shqipërisë

Oferta totale e parasë, e matur nga agregati M3, arriti në rreth 1,858,397 milionë lekë në muajin korrik 2025, duke shënuar një rritje prej 142,528 milionë lekë krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë, pra një rritje vjetore prej 8.3 përqind.

Në muajin korrik, sistemi bankar rezultoi me rritje mujore prej 27,339 milionë lekë, ose 1.5 përqind më shumë krahasuar me muajin qershor 2025.

Fig. 8




Agregati M3 Korrik'24-Korrik'25

Burimi: Banka e Shqipërisë

# 6. Kredia për Ekonominë

Totali i kredisë për ekonominë në muajin korrik 2025 arriti në rreth 893,110 milionë lekë. Bilanci i kredisë, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë, shënoi rritje në vlerë me 94,809 milionë lekë, ose rritje me rreth 11.9 përqind. Struktura e kredisë sipas monedhave është e balancuar mes monedhës kombëtare (58.3%) dhe monedhave të huaja (41.7%).

Fig. 9




Rritja e stokut total të kredive Korrik'25

Burimi: Banka e Shqipërisë

Gjatë muajit korrik 2025, zëri "Korporata të tjera jofinanciare", zuri peshën më të lartë të totalit të kredive, me rreth 54.9 përqind ose 490,412 milionë lekë, ndjekur nga kreditë për Individë, ku pesha e tyre specifike arriti në nivelin rreth 40.4 përqind ose rreth 360,528 milionë lekë. Zërat "Korporata jofinanciare publike" dhe "Korporata të tjera financiare" arritën respektivisht 2.3 dhe 2.4 përqind, ose 20,365 dhe 21,792 milionë lekë.

Fig. 10




Përbërja e kredive Korrik'25

Burimi: Banka e Shqipërisë

Për sa i përket shpërndarjes së kredisë sipas monedhës së huaj për muajin korrik 2025, zëri "Koorporata të tjera jofinanciare" zuri peshën më të lartë të kredive, me rreth 72.0 përqind, ndjekur nga "Sektorë të tjerë rezidentë" me rreth 22.8 përqind. "Koorporata të tjera financiare" dhe "Koorporata jofinanciare publike" kontribuojnë përkatësisht me 2.4 dhe 2.8 përqind secili.

## 7. Oferta e Parasë

Paraja jashtë Korporatave Depozituese arriti në rreth 451,619 milionë lekë në fund të muajit korrik 2025. Raporti i Parasë jashtë Bankave me M3 në korrik 2025 ka shënuar një rritje mujore prej 0.17 pikë përqindje dhe rritje vjetore prej 0.84 pikë përqindje, duke arritur nivelin 24.3 përqind. Raporti i Parasë jashtë Bankave me Depozitat ka shënuar rritje mujore prej 0.29 pikë përqindje dhe rritje vjetore prej 1.44 pikë përqindje, duke shënuar nivelin 32.1 përqind.

Fig. 11




Raporte të parasë jashtë bankave me M3 & Depozitat
Burimi: Banka e Shqipërisë

Depozitat në valutë, si përbërësi kryesor i ofertës monetare për muajin korrik 2025, kanë shënuar rritje vjetore prej rreth 23,017 milionë lekë, e sjellë kryesisht nga depozitat për Individë, të cilat përbëjnë rreth 74.7 përqind të depozitave në valutë. Gjithashtu depozitat në Lekë, gjatë muajit korrik 2025, shënuan rritje prej 70,524 milionë lekë në krahasim me muajin korrik 2024. Sektori i Individëve në Lekë ka zënë 75.7 përqind të depozitave në lekë.

Fig. 12




Raporti i Depozitave ndaj M3 Korrik'25
Burimi: Banka e Shqipërisë

Në muajin korrik 2025, depozitat totale përbëjnë 75.7 përqind të agregatit M3, me një rënie rreth 0.84 pikë përqindje krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë.

## 8. Depozitat sipas Burimeve

Gjatë muajit korrik 2025, zëri "Sektorë të tjerë rezidentë" zuri nivelin më të lartë të depozitave të transferueshme në lekë, me rreth 75.7 përqind, ndjekur nga "Koorporata të tjera jofinanciare", me rreth 17.5 përqind dhe nga "Koorporata jofinanciare publike" me 4.2 përqind. "Sektorë të tjerë rezidentë" dhe "Koorporata të tjera jofinanciare" ishin gjithashtu burimi më i rëndësishëm i depozitave në monedhë të huaj, përkatësisht me rreth 74.7 përqind dhe rreth 22.5 përqind. "Sektorë të tjerë rezidentë" ishin dukshëm burimi më i rëndësishëm i depozitave totale me rreth 75.2 përqind të totalit.

Fig. 13




Rritja e stokut total të depozitave Korrik'25
Burimi: Banka e Shqipërisë

Në total, "Sektorë të tjerë rezidentë" përbëjnë pjesën më të madhe me rreth 1,058,083 milionë lekë të depozitave totale. Ato ndiqen nga "Koorporata të tjera jofinanciare" (283,268 milionë lekë), "Koorporata jofinanciare publike" (35,355 milionë lekë), "Koorporata të tjera financiare" (23,138 milionë lekë) dhe "Qeveria lokale" me rreth 6,935 milionë lekë në totalin e depozitave. Gjatë muajit korrik 2025, niveli i përgjithshëm i depozitave arriti vlerën rreth 1,406,779 milionë lekë. Krahasuar me një muaj më parë, niveli i depozitave shënoi rritje me rreth 17,623 milionë lekë. Ndërsa krahasuar me një vit më parë, totali i depozitave ka shënuar rritje me 93,541 milionë lekë.

Fig. 14




Përbërja e depozitave Korrik'25
Burimi: Banka e Shqipërisë

# Sektori Fiskal

## 1. Buxheti i Konsoliduar

Për periudhën janar-korrik 2025 janë mbledhur rreth 433.5 miliardë lekë të ardhura, përkundrejt shpenzimeve të përgjithshme prej rreth 401.9 miliardë lekë, ku pjesa më e madhe përfshin 357.3 miliardë lekë shpenzimet korrente, nga të cilat rreth 148.0 miliardë lekë shpenzime për fonde speciale.

Fig. 15




Treguesit Fiskalë, Korrik'25

Burimi: Ministria e Financave

Nga të ardhurat gjithsej, pjesa e të ardhurave të mbledhura nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve (pa përfshirë kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore) dhe Doganave është rreth 287.1 miliardë lekë (0.6% më shumë se plani i periudhës). Të ardhurat e mbledhura nga pushteti vendor janë rreth 22.7 miliardë lekë (2.2% më shumë se plani i periudhës). Të ardhurat nga fondet speciale janë rreth 104.2 miliardë lekë (ose 2.3% më shumë se plani i periudhës) dhe të ardhurat jotatimore në nivelin 16.5 miliardë lekë (ose rreth 7.1% më shumë se plani i periudhës).

Nga totali i shpenzimeve korrente prej 357.3 miliardë lekë, 72.8 miliardë lekë (20.4% e totalit të shpenzimeve korrente) është shpenzuar për personelin, rreth 38.7 miliardë lekë (10.8% e totalit të shpenzimeve korrente) për shpenzime interesi, 38.1 miliardë lekë (10.7% e totalit të shpenzimeve korrente) për shpenzime operative dhe mirëmbajtje, 1.2 miliardë lekë (0.3% e totalit të shpenzimeve korrente) për subvencione, 148.0 miliardë lekë (41.4%) për shpenzime për fonde speciale, 44.2 miliardë lekë (12.4% e totalit të shpenzimeve korrente) për shpenzimet e qeverisjes vendore, dhe 14.3 miliardë lekë (4.0% e totalit të shpenzimeve korrente) për shpenzime të tjera.

## 2. Të ardhurat sipas burimeve

Të ardhurat gjithsej të realizuara për periudhën janar-korrik 2025 ishin rreth 433.5 miliardë lekë, nga të cilat të ardhurat tatimore rreth 414.0 miliardë lekë, të ardhurat jotatimore në rreth 16.5 miliardë lekë.

**Tab - 2** **Të ardhurat tatimore gjatë muajit Korrik 2025 (mln Lekë)**

| Emërtimi | Korrik'25 | Korrik'24 | Korrik'25/ Korrik'24 Rritja në (%) |
|---|---|---|---|
| Tatimi mbi Vlerën e Shtuar | 130,307 | 122,253 | 6.6 |
| Tatimi mbi Fitimin | 37,093 | 36,058 | 2.9 |
| Akcizat | 39,010 | 34,891 | 11.8 |
| Tatimi mbi të Ardhurat Personale | 48,251 | 38,141 | 26.5 |
| Taksa Nacionale dhe të tjera | 27,017 | 24,946 | 8.3 |
| Taksa Doganore | 5,481 | 5,210 | 5.2 |

Burimi*:* Ministria e Financave, Statistikat Fiskale: Shtator 2025

## 3. Financimi i Bilancit Fiskal

Balanca buxhetore për periudhën janar-korrik 2025 shënoi një vlerë pozitive prej rreth 31.6 miliardë lekë, ndërkohë që ishte planifikuar një suficit prej 29.6 miliardë lekë.

Për periudhën janar-korrik 2025, disa nga treguesit kryesorë fiskalë ishin:

- Realizimi i të ardhurave në masën 433.5 miliardë lekë;

- Realizimi i shpenzimeve në masën 401.9 miliardë lekë.

Në realizimin e të ardhurave për periudhën janar-korrik 2025, kontributin kryesor e kanë dhënë të ardhurat tatimore, të cilat arrijnë shifrën e 414.0 miliardë lekë. Në realizimin e shpenzimeve për këtë periudhë, peshën më të lartë e zënë shpenzimet korrente me 357.3 miliardë lekë dhe shpenzimet për fonde speciale me rreth 148.0 miliardë lekë.

# Aneksi Statistikor

Tab - 1

| Muaji | Mujor (Monthly) | | | | | Mesatar Mujor (Monthly Average) | | | | | Vjetor (Annual) | | | | | Month |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | 2021 | 2022 | 2023 | 2024 | 2025 | 2021 | 2022 | 2023 | 2024 | 2025 | 2021 | 2022 | 2023 | 2024 | 2025 | |
| Janar | 1.3 | 1.3 | 1.1 | 0.5 | 0.4 | 1.3 | 1.3 | 1.1 | 0.5 | 0.4 | 0.4 | 3.7 | 7.2 | 3.4 | 2.0 | January |
| Shkurt | 1.1 | 1.3 | 1.1 | 0.3 | 0.3 | 1.2 | 1.3 | 1.1 | 0.4 | 0.4 | 1.1 | 3.9 | 7.1 | 2.6 | 1.9 | February |
| Mars | 0.7 | 2.4 | 0.7 | 0.4 | 0.6 | 1.0 | 1.7 | 1.0 | 0.4 | 0.4 | 1.2 | 5.7 | 5.3 | 2.3 | 2.1 | March |
| Prill | 0.2 | 0.7 | 0.0 | -0.2 | 0.1 | 0.8 | 1.4 | 0.9 | 0.3 | 0.4 | 1.9 | 6.2 | 4.6 | 2.1 | 2.3 | April |
| Maj | -0.9 | -0.5 | -0.3 | -0.2 | -0.3 | 0.5 | 1.0 | 0.7 | 0.2 | 0.2 | 1.8 | 6.7 | 4.7 | 2.2 | 2.2 | May |
| Qershor | -0.8 | -0.1 | -0.3 | -0.4 | -0.2 | 0.3 | 0.9 | 0.6 | 0.3 | 0.2 | 1.6 | 7.4 | 4.5 | 2.1 | 2.4 | June |
| Korrik | 0.1 | 0.2 | -0.1 | -0.2 | **-0.1** | 0.2 | 0.8 | 0.5 | 0.2 | **0.1** | 2.2 | 7.5 | 4.2 | 2.1 | **2.5** | July |
| Gusht | 0.4 | 0.8 | 0.6 | 0.5 | | 0.3 | 0.8 | 0.5 | 0.2 | | 2.4 | 8.0 | 4.0 | 2.0 | | August |
| Shtator | 0.5 | 0.6 | 0.7 | 0.6 | | 0.3 | 0.7 | 0.4 | 0.2 | | 2.5 | 8.1 | 4.1 | 1.9 | | September |
| Tetor | 0.1 | 0.4 | 0.1 | 0.1 | | 0.3 | 0.7 | 0.4 | 0.2 | | 2.4 | 8.3 | 3.8 | 1.9 | | October |
| Nëntor | 0.2 | -0.3 | -0.2 | 0.0 | | 0.3 | 0.6 | 0.3 | 0.1 | | 3.1 | 7.9 | 3.9 | 2.0 | | November |
| Dhjetor | 0.8 | 0.4 | 0.5 | 0.6 | | 0.3 | 0.6 | 0.3 | 0.2 | | 3.7 | 7.4 | 4.0 | 2.1 | | December |

***Burimi* : *INSTAT***

***Source* : *INSTAT***

Tab - 2 **Kursi i këmbimit**
*Exchange rate*

| Monedha | 2021 | 2022 | 2023 | 2024 | 2025 Janar January | 2025 Shkurt February | 2025 Mars March | 2025 Prill April | 2025 Maj May | 2025 Qershor June | 2025 Korrik July | Currency |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| *Mesatarja e periudhës* | | | | | | | | | | | | *Average of period* |
| USD | 103.68 | 113.04 | 100.65 | 93.09 | 95.09 | 95.10 | 91.90 | 88.33 | 86.97 | 85.11 | 83.62 | USD |
| EURO | 122.37 | 118.98 | 108.80 | 100.71 | 98.51 | 99.03 | 99.23 | 99.07 | 98.21 | 98.07 | 97.72 | EURO |
| *Fundi i periudhës* | | | | | | | | | | | | *In the end of period* |
| USD | 106.54 | 107.05 | 93.94 | 94.26 | 96.14 | 95.41 | 92.15 | 86.78 | 86.86 | 83.67 | 85.21 | USD |
| EURO | 120.76 | 114.23 | 103.88 | 98.15 | 99.80 | 99.23 | 99.29 | 98.71 | 98.39 | 98.08 | 97.47 | EURO |

***Burimi :*** *Banka e Shqipërisë* ***Source :*** *Bank of Albania*

Tab - 3 **Normat e interesit me bazë vjetore (në Lek)**
*Annual Interest Rates (in ALL)*

| Në përqindje | 2025 Janar January | 2025 Shkurt February | 2025 Mars March | 2025 Prill April | 2025 Maj May | 2025 Qershor June | 2025 Korrik July | In percent |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| *Norma e interesit të depozitave për individët* | | | | | | | | *Interest rates on households deposits* |
| Deri në 1 vit | 1.30 | 1.26 | 1.25 | 1.20 | 1.22 | 1.25 | 1.28 | Up to 1 year |
| Nga 1-2 vite | 2.47 | 2.29 | 1.78 | 2.27 | 2.03 | 1.99 | 2.02 | From 1 to 2 years |
| Mbi 2 vjet | 2.67 | 2.57 | 2.66 | 2.26 | 2.56 | 2.57 | 2.43 | Over 2 years |
| Norma e interesit të depozitave për korporatat jofinanciare | | | | | | | | *Interest rates on nonfinancial corporations deposits* |
| Deri në 1 vit | 2.46 | 2.35 | 2.28 | 2.76 | 2.34 | 2.27 | 2.34 | Up to 1 year |
| Nga 1-2 vite | 2.97 | 3.09 | 3.20 | 3.29 | 3.29 | 2.63 | 2.27 | From 1 to 2 years |
| Mbi 2 vjet | 3.20 | 2.16 | 3.75 | 2.72 | 3.12 | 1.78 | 3.19 | Over 2 years |
| *Normat e interesit të kredive për individët* | | | | | | | | *Interest rates on household loans* |
| Kredi për banesa | 3.58 | 3.82 | 3.64 | 3.82 | 3.85 | 3.84 | 3.76 | Lending for house purchase |
| Kredi konsumatore | 8.21 | 7.96 | 8.54 | 8.83 | 8.87 | 8.88 | 9.16 | Consumer credit |
| Kredi për qëllime të tjera | 8.46 | 11.21 | 10.71 | 10.53 | 9.34 | 8.58 | 8.86 | Credit for other purposes |
| *Normat e interesit të kredive për korporatat jofinanciare* | | | | | | | | *Interest rates on nonfinancial corporations loans* |
| Kredi deri në 140 milionë lekë | 6.89 | 6.81 | 6.67 | 6.69 | 6.68 | 6.65 | 6.65 | Loans up to to an amount of 140 millions of lek |
| Kredi mbi 140 milionë lekë | 5.92 | 6.35 | 5.52 | 7.45 | 6.56 | 6.44 | 6.99 | Loans over an amount of 140 millions of lek |
| *Norma e letrave me vlerë* | | | | | | | | *Securities rates* |
| Bono thesari 1/ | | | | | | | | Treasury bills 1/ |
| 3-M | - | 2.60 | - | - | 2.60 | - | - | 3-M |
| 6-M | - | - | 2.63 | - | - | 2.62 | - | 6-M |
| 12-M | 2.78 | 2.78 | 2.72 | 2.75 | 2.75 | 2.75 | 2.68 | 12-M |

***Burimi:*** *Banka e Shqipërisë* | ***Source :*** *Bank of Albania*

Tab - 4 **TREGUESIT FISKAL SIPAS BUXHETIT TË KONSOLIDUAR 2025**

Fiscal indicators regarding consolidated budget of 2025

*Të dhëna progresive (Progresive Data)* *në milionë Lek (in million ALL)*

| Nr. | E M Ë R T I M I | January Janar | February Shkurt | March Mars | April Prill | May Maj | June Qershor | July Korrik | ITEMS |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | **TOTALI TË ARDHURAVE** | **64,610** | **116,867** | **181,106** | **246,841** | **306,201** | **365,966** | **433,455** | **TOTAL REVENUE** |
| **I.** | **Të ardhura nga ndihmat** | **1,326** | **919** | **1,267** | **1,697** | **1,916** | **2,082** | **2,946** | **Grands** |
| **II.** | **Të ardhura tatimore** | **60,760** | **111,217** | **173,245** | **235,580** | **292,365** | **349,424** | **414,011** | **Tax Revenue** |
| **II.1** | **Nga Tatimet dhe Doganat** | **42,637** | **77,740** | **123,393** | **163,885** | **203,426** | **242,327** | **287,089** | **From tax offices and customs** |
| 1 | Tatimi mbi Vlerën e Shtuar | 22,020 | 38,614 | 56,617 | 74,351 | 92,764 | 109,091 | 130,307 | V.A. T |
| 2 | Tatimi mbi Fitimin | 2,964 | 6,402 | 17,392 | 24,478 | 28,472 | 33,237 | 37,093 | Profit Tax |
| 3 | Akcizat | 4,867 | 9,466 | 14,574 | 19,966 | 25,707 | 32,083 | 39,010 | Excise Tax |
| 4 | Tatimi mbi të Ardhurat Personale | 7,277 | 13,549 | 20,748 | 27,182 | 34,054 | 40,810 | 48,251 | Personal Income Tax |
| 5 | Taksa Nacionale dhe të tjera | 4,923 | 8,461 | 12,015 | 15,069 | 18,755 | 22,595 | 26,948 | National Taxes and others |
| 6 | Taksa Doganore | 586 | 1,248 | 2,045 | 2,839 | 3,673 | 4,511 | 5,481 | Customs Duties |
| **II.2** | **Të ardhura nga Pushteti Vendor** | **1,855** | **3,406** | **5,971** | **12,061** | **15,062** | **19,125** | **22,687** | **Revenues from Local Gov.** |
| 1 | Taksë mbi Pasurinë (ndërtesat) | 406 | 813 | 1,426 | 3,296 | 3,876 | 4,724 | 5,333 | Property Tax |
| 2 | Taksë mbi Biznesin e vogël | 1 | 6 | 12 | 4 | 5 | 10 | 15 | Small Business Tax |
| 3 | Taksa Lokale | 1,448 | 2,586 | 4,533 | 8,761 | 11,181 | 14,390 | 17,339 | Local Taxes |
| **II.3** | **Të ardhura nga fondet speciale** | **16,267** | **30,072** | **43,881** | **59,633** | **73,877** | **87,973** | **104,235** | **Social ins. contributions** |
| 1 | Sigurimi Shoqëror | 14,011 | 25,992 | 37,971 | 51,468 | 63,788 | 76,019 | 89,963 | Social Insurance |
| 2 | Sigurimi Shëndetësor | 2,200 | 3,962 | 5,712 | 7,889 | 9,735 | 11,532 | 13,779 | Health insurance |
| 3 | Të ardhura për kompensim në vlerë të pronarëve | 56 | 118 | 198 | 277 | 353 | 421 | 493 | Compensation income in the value of owners |
| **III.** | **Të ardhura Jotatimore** | **2,525** | **4,730** | **6,594** | **9,564** | **11,920** | **14,460** | **16,498** | **Nontax Revenue** |
| 1 | Tran.Fitimi nga Banka e Shqipërisë | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | Profit transfer from BOA |
| 2 | Të ardhura nga Inst.Buxhetore | 1,139 | 2,526 | 3,509 | 4,583 | 5,910 | 7,447 | 8,399 | Income of budgetary institutions |
| 3 | Tarifat shërbimeve | 306 | 544 | 774 | 1,014 | 1,268 | 1,558 | 1,998 | Utility fees |
| 4 | Të tjera | 1,081 | 1,660 | 2,311 | 3,951 | 4,726 | 5,430 | 6,075 | Others |
| | **TOTALI I SHPENZIMEVE** | **46,460** | **93,880** | **147,351** | **208,771** | **267,145** | **332,453** | **401,888** | **TOTAL EXPENDITURE** |
| **I.** | **Shpenzime Korrente** | **44,554** | **90,721** | **139,103** | **193,030** | **243,495** | **299,624** | **357,294** | **Current Expenditures** |
| **I.1** | **Personeli** | **9,987** | **20,229** | **30,444** | **40,977** | **51,541** | **62,080** | **72,835** | **Personnel expenditures** |
| 1 | Paga | 8,552 | 17,351 | 26,101 | 35,144 | 44,201 | 53,232 | 62,337 | Wages |
| 2 | Kontributi për Sigurime Shoqërore | 1,425 | 2,847 | 4,272 | 5,730 | 7,186 | 8,647 | 10,102 | Social insurance contributions |
| 3 | Arsimi i lartë nga të ardhurat e veta | 10 | 31 | 71 | 103 | 154 | 201 | 397 | Higher education from its own income |
| **I.2** | **Interesat** | **8,865** | **13,451** | **17,919** | **21,203** | **23,482** | **30,290** | **38,665** | **Interest** |
| 1 | Të Brendshme | 7,536 | 11,607 | 14,726 | 17,094 | 18,392 | 18,985 | 26,182 | Domestic |
| 2 | Të Huaja | 1,329 | 1,844 | 3,193 | 4,109 | 5,090 | 11,305 | 12,484 | Foreign |
| **I.3** | **Shpenzime Operative Mirëmbajtje** | **2,121** | **5,913** | **10,214** | **17,744** | **23,793** | **30,439** | **38,131** | **Operational & Maintenance** |
| **I.4** | **Subvecionet** | **35** | **187** | **308** | **826** | **922** | **1,077** | **1,180** | **Subsidies** |
| **I.5** | **Shpenzime për fonde speciale** | **18,166** | **38,363** | **59,130** | **82,014** | **104,739** | **127,096** | **148,022** | **Social insurance outlays** |
| 1 | Sigurime Shoqërore | 14,445 | 29,064 | 45,401 | 62,018 | 79,098 | 95,976 | 111,592 | Social insurance |
| 2 | Sigurime Shëndetësore | 3,715 | 9,131 | 13,564 | 19,462 | 25,150 | 30,591 | 35,749 | Health insurance |
| 3 | Fondi i kompensimit të pronarëve | 6 | 168 | 165 | 535 | 491 | 529 | 681 | Owners' Compensation Fund |
| **I.6** | **Shpenzime për Buxhetin Vendor** | **3,944** | **9,263** | **15,575** | **22,649** | **29,252** | **36,558** | **44,195** | **Local budget expenditure** |
| **I.7** | **Shpenzime të tjera** | **1,436** | **3,314** | **5,512** | **7,617** | **9,766** | **12,084** | **14,267** | **Other expenditures** |
| 1 | Pagesa e Papunesisë | 55 | 111 | 168 | 227 | 279 | 330 | 382 | Unemployment insurance benefits |
| 2 | Ndihma Ekonomike | 1,381 | 3,200 | 5,149 | 7,042 | 8,995 | 10,938 | 12,886 | Economic Aid |
| 3 | Kompensim për ish të përndjekurit politike | 0 | 3 | 95 | 148 | 193 | 316 | 399 | Birth bonus |
| **I.8** | **Transferime Kapitale** | **0** | **0** | **0** | **867** | **867** | **867** | **873** | **Capital transfers** |
| **II** | **Fondi Rezerve, Kontigjenca** | **0** | **0** | **0** | **0** | **0** | **0** | **0** | **Reserve fund/contigency** |
| **III** | **Shpenzime Kapitale** | **1,906** | **3,159** | **8,248** | **14,874** | **22,782** | **31,962** | **43,721** | **Capital expenditures** |
| 1 | Financimi i Brendshëm | 0 | 202 | 3,937 | 9,183 | 15,054 | 22,931 | 30,695 | Domestically financing |
| 2 | Investime nga të ardhurat e Arsimit të Lartë | 0 | 31 | 100 | 103 | 160 | 210 | 294 | From higer education system's own revenues |
| 3 | Financimi i Huaj | 1,906 | 2,925 | 4,028 | 5,241 | 7,025 | 7,631 | 11,177 | Foreign financed |
| **IV** | **Fondi i rindërtimit** | **0** | **2** | **183** | **347** | **543** | **1189** | **1,555** | **Reconstruction fund** |
| **V.** | **DEFICITI** | **18,150** | **22,987** | **33,754** | **38,069** | **39,056** | **33,512** | **31,566** | **CASH BALANCE** |
| **V.1** | **FINANCIMI DEFICITIT** | **-18,150** | **-22,987** | **-33,754** | **-38,069** | **-39,056** | **-33,512** | **-31,566** | **CASH BALANCE FINANCING** |
| **V.2** | **Brendshëm** | **-14,684** | **-81,214** | **-92,432** | **-92,832** | **-92,017** | **-84,732** | **-64,741** | **Domestic** |
| 1 | Të ardhura nga privatizimi | 1 | 226 | 236 | 238 | 239 | 240 | 295 | Privatization receipts |
| 2 | Hua-marrje e brendshme | -5,044 | -6,915 | -6,535 | -4,323 | 6,548 | 11,889 | 6,997 | Domestic new borrowing (net) |
| 3 | Të tjera | -9,641 | -74,525 | -86,133 | -88,748 | -98,803 | -96,861 | -72,033 | Others |
| **V.3** | **I huaj** | **-3,466** | **58,226** | **58,677** | **54,763** | **52,961** | **51,220** | **33,175** | **Foreign** |
| 1 | Hua afatgjatë(e marrë) | 680 | 64,682 | 65,448 | 66,900 | 68,495 | 69,136 | 71,801 | Long-term foreign borrowing (gross) |
| 2 | Ndryshimi i gjendjes së arkes* | -63 | 476 | 541 | 19 | 44 | -105 | -30 | Chang. of stat. Account |
| 3 | Ripagesat | -4,083 | -6,932 | -10,283 | -15,127 | -18,549 | -20,784 | -42,138 | Repayments |
| 4 | Mbështetje Buxhetore | 0 | 0 | 2,972 | 2,972 | 2,972 | 2,972 | 3,543 | Budgetary Support |

***Burimi** : Ministria e Financave* ***Source** : Ministry of Finance*

* *"Ndryshimi i gjendjes së arkës" përfaqëson ndryshimin e Depozitës së Financimeve të Huaja.*

Tab - 5

**Tabela e investimeve 2025**

*Table of investments 2025*

*Të dhëna progresive (Progresive Data)* *në milionë Lek (in million ALL)*

| | Janar January | Shkurt February | Mars March | Prill April | Maj May | Qershor June | Korrik July | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Financim i brendshëm | **-14,684** | **-81,214** | **-92,432** | **-92,832** | **-92,017** | **-84,732** | **-64,741** | Domestic financing |
| *Në %* | 80.9 | 353.3 | 273.8 | 243.9 | 235.6 | 252.8 | 205.1 | *In %* |
| Financim i huaj | **-3,466** | **58,226** | **58,677** | **54,763** | **52,961** | **51,220** | **33,175** | Foreign financing |
| *Në %* | 19.1 | -253.3 | -173.8 | -143.9 | -135.6 | -152.8 | -105.1 | *In %* |
| Totali | **-18,150** | **-22,987** | **-33,754** | **-38,069** | **-39,056** | **-33,512** | **-31,566** | Total |
| *Në %* | 100 | 100 | 100 | 100 | 100 | 100 | 100 | *In %* |

**Burimi:** Ministria e Financave **Source:** Ministry of Finance

Tab - 6 **TË ARDHURAT DOGANORE DHE TATIMORE 2025**
**CUSTOMS AND TAX REVENUES 2025**

